a) shkeljet e dispozitave të neneve 3, 4, 5, 8, 10, 11 dhe 12 të këtij ligji, që rrezikojnë sigurinë e njerëzve, të kafshëve shtëpiake dhe të vlerave materiale;

b) shkeljet e përsëritura të konstatuara nga inspektori;

c) tejkalimi i afatit të lënë nga inspektori për mënjanimin e shkeljeve.”.

2. Paragrafi i dytë i pikës 2 ndryshohet si më poshtë:

“Inspektori që vëren shkeljen, harton procesverbalin dhe vendos gjobën, në përputhje me ligjin për inspektimin.”.

3. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Shqyrtimi, marrja e vendimit përfundimtar dhe ankimi ndaj vendimit bëhen në përputhje me ligjin për inspektimin.”.

4. Pikat 5 dhe 6 shfuqizohen.

Neni 14

Në nenin 20, paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:

“1. Gjoba paguhet nga kundërvajtësit brenda 30 ditëve nga data kur vendimi ka marrë formë të prerë. Pas kalimit të këtij afati, për çdo ditë vonesë, paguhet një kamatë prej 2 për qind deri në një muaj. Kur edhe pas këtij afati gjoba nuk paguhet, atëherë zbatohet legjislacioni në fuqi për kundërvajtjet administrative.”.

Neni 15
**Dispozitë kalimtare**

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 16

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 14.2.2013

**Shpallur me dekretin nr. 7967, datë 1.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani**

## LIGJ
## Nr. 9/2013

## PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 10 304, DATË 15.7.2010 “PËR SEKTORIN MINERAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, bëhet ndryshimi si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 2, pika 35 ndryshohet si më poshtë:

"35. "Strukturë përgjegjëse" është institucioni shtetëror, i përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, për të siguruar zbatimin e këtij ligji. Për qëllime dhe në funksion të veprimtarisë inspektuese, strukturë përgjegjëse do të nënkuptojë Inspektoratin Shtetëror përkatës, të caktuar në përputhje me ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë".".

Neni 2
**Dispozitë kalimtare**

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 14.2.2013

**Shpallur me dekretin nr. 7968, datë 1.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani**

**LIGJ**
**Nr. 10/2013**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9947, DATË 7.7.2008 "PËR PRONËSINË INDUSTRIALE"**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9947, datë 7.7.2008 "Për pronësinë industriale", bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Kudo në ligj fjalët "Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut" zëvendësohen me fjalët "Inspektorati që mbulon fushën e mbikëqyrjes së tregut".

Neni 2

Në nenin 199, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Çdo veprim i kryer në kundërshtim me përcaktimet e neneve 36, 127, 156 e 178 të këtij ligji, për shkelje të të drejtave të pronësisë industriale, kur nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me dënim kryesor me gjobë nga 100 000 deri në 500 000 lekë. Gjobat vendosen nga inspektorati që mbulon fushën e mbikëqyrjes së tregut.".